



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1784/Prot.
12

Pogradec, më 20.09.2026

PROJEKT - VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2026

**“PËR MIRATIMIN E ZGJATJES TË PERIUDHËS SË NGROHJES NË
INSTITUCIONET ARSIMORE TË BASHKISË POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 3, neni 23, pika 11 dhe 12 e në vijim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore", i ndryshuar, të nenit 28, pika 2, germa "ç" të Ligjit Nr.69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjatjen e periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore në Bashkinë Pogradec për periudhën nga data 01 Nëntor deri në 31 Mars.
2. Ngarkohet Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Agjencia e Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").
4. U shpall sot më datë __.04.2026.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1784 Prot.
2

Pogradec, më 20.09.2026

**RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN
ME OBJEKT:**

**“PËR MIRATIMIN E ZGJATJES TË PERIU DHËS SË NGROHJES NË
INSTITUCIONET ARSIMORE TË BASHKISË POGRADEC”**

**I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT!
TË NDERUAR KËSHILLTARË!**

**KREU I
HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË**

Bazuar në nenin 23, pika 11 dhe 12 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, një nga funksionet kryesore të njësisë është ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale si dhe administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Gjithashtu, në nenin 28, pika 2, germa “ç”, përcaktohet se një ndër kompetencat kryesore të njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore është dhe garantimi i kushteve higjieno-sanitare dhe i ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

Në Bashkinë Pogradec janë adresuar vazhdimisht kërkesa nga drejtuesit e institucioneve arsimore, si dhe nga prindërit e nxënësve, për zgjatjen e periudhës së ngrohjes me të paktën 1 muaj.

Për shkak të kushteve atmosferike dhe temperaturave të ulëta gjatë periudhës nga data 01 nëntor deri në 31 mars, është e nevojshme sigurimi i ngrohjes së ambienteve për të arritur temperaturat optimale për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Aktualisht, periudha e ngrohjes është nga data 15 nëntor deri më 15 mars, periudhë e cila nuk arrin të garantojë kushte të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Për këto arsye, kërkojmë zgjatjen e afatit të ngrohjes me 30 ditë, me qëllim garantimin e kushteve bazë për nxënësit në Bashkinë Pogradec.



KREU II
INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE

Ky relacion mbeshtetet në nenin 3, neni 23 pika 11 dhe 12 e në vijim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore", i ndryshuar, te nenit 28, pika 2, germa "ç" të Ligjit Nr.69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015.

Ky projekt-vendim është një akt administrativ me karakter normativ.

Për sa më sipër, duke krijuar bindjen që projekt-vendimi është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Jini të lutur të miratoni projekt-vendimin bashkëngjitur.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi:	PERGJEGJES SEKTORI KRYEINSPEKTOR	ERION QAFKO KLEDI LUFO
Pranoi:	DREJTOR DREJTORIE DREJTOR AMT	ENTON BERBERI MARKEL HAFESLLARI
Miratoi:	NËNKRYETAR	PASKALINO ZIKO
Konfirmoi:	KRYETAR	ILIR XHAKOLLI